



BASHKIMI EVROPIAN

Delegacioni i Bashkimit Evropian

Manastir, 9 tetor 2012

**Ekspozitë e fotografive: "Uji dhe malet në zonën  
ndërkufitare"  
Me rastin e Ditës Evropiane për Bashkëpunim  
Territorial, në Manastir**

Fjalim nga  
Ambasadori Aivo Orav  
Shef i Delegacionit të BE-së

**Të nderuar përfaqësues të Autoriteteve Menaxhuese për bashkëpunim ndërkufitar - zj. Mehmeti Petersen dhe z. Salonidis,**

**I nderuari Kryetar Komune Taleski,**

**Ladies and gentlemen,**

Kam nderin të jem në mesin tuaj, gjatë hapjes zyrtare të ekspozitës së fotografive të titulluar: **Uji dhe malet në zonën ndërkufitare**, e cila u organizua me rastin e Ditës Evropiane për Bashkëpunim Territorial.

Bashkimi Evropian ka zhvilluar instrumente të ndryshme për të përkrahur bashkëpunimin territorial në Evropë. Njëri nga këto instrumente është **Programi IPA për bashkëpunim Ndërkufitar** i cili ka për qëllim të përgatisë vendet candidate për menaxhimin e ardhshëm të Fondeve Strukturore të BE-së. Në nivel institucional, Programi për Bashkëpunim Ndërkufitar me Greqinë menaxhohet bashkarisht nga Programet e Autoriteteve Menaxhuese për Bashkëpunim Evropian Territorial nga Selaniku dhe Ministria e Vetqeverisjes Lokale nga Shkupi.

Në këtë program, partnerët pjesëmarrës siç janë komunat, strukturat rajonale për zhvillim dhe shoqëria civile, **implementojnë projekte të përbashkëta** duke kombinuar ekspertizën dhe burimet.

Kjo mundëson që aktivitetet ndërkufitare të mbështesin zhvillimin ekonomik vendor, të ndërtojnë infrastrukturë të shkallës së ulët, të mbrojnë mjedisin dhe të nxisin këmbimin kulturor në mes të shteteve fqinje.

Programi për Bashkëpunim Ndërkufitar me Greqinë implementohet me anë të thirrjes publike për propozime. Në vitin 2010 u shpall **thirrja e parë**, e cila rezultoi me 18 projekte, me një vlerë të përgjithshme rreth 2 milionë euro, të ndara për partnerët nga kjo anë e kufirit. Autoritetet vendore kontribuojnë me rreth 15% në buxhetin e projekteve.

**Thirrja e dytë për propozime** u shpall në fillim të këtij viti, me buxhet prej rreth 4,8 milionë euro, që do të ndahen për partnerët nga vendi.

Një nga projektet e shpërblyera për bashkëpunim ndërkufitar implementohet nga Shoqëria Kulturo-Artistike "Stiv Naumov" nga Manastiri dhe sot kemi kënaqësinë të shohim performancën e tyre. Ky projekt është shembull i mirë i bashkëpunimit të përforcuar midis dy vendeve në fushën e kulturës.

Fushat e tjera të aktiviteteve të projektit u dedikohen:

- ruajtja e mjedisit;

- valorizimi i burimeve natyrore rajonale; dhe nxitja e shkëmbimeve kulturore.

Në mbarë Evropën organizohen më se 300 evenimente në 40 shtete, në suaza të fushatës së Ditës Evropiane për Bashkëpunim, e cila inkurajon Bashkëpunimin Territorial. Edhe qyteti i Manastirit i bashkangjitet kësaj iniciative. Kjo tregon interesimin e autoriteteve vendore dhe rajonale, si dhe shoqërinë civile për bashkëpunim më të mirë në kufijtë e Evropës, me të cilat mburremi sot.

Ju falemnderit për vëmendjen.